

**Vendim nr. 25 datë 13.10.2022**

**(V-25/22)**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Vitore Tusha, Kryetare, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Altin Binaj, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marsida Xhaferllari, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datat 22.09.2022 dhe 13.10.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 6 (B) 2022 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

**KËRKUES:**                   **BASHKIM DEDJA**  
**LATIF DEDJA**

**SUBJEKT I INTERESUAR:**  
**PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

**OBJEKTI:**                   **Shfuqizimi i vendimeve nr. 00-2021-815, datë 21.10.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr. 132, datë 01.06.2021 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 8, datë 20.04.2021 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**BAZA LIGJORE:**   Nenet 18, pika 1, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, pikat 1 dhe 2, 71, pika 1, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesve, të cilët kërkuan pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 137/2020 ndaj kërkuesit Bashkim Dedja (*kërkuesi i parë*), si i dyshuar për veprën penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram”, të parashikuar nga neni 257/a, paragrafi 2, i Kodit Penal (*KP*), të kryer në kohën e ushtrimit të detyrës së gjyqtarit dhe kryetarit të Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*).

2. Gjatë hetimeve paraprake, Prokuroria e Posaçme, bazuar në ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 10192/2009*), ka regjistruar procedimin pasuror nr. 4, datë 15.04.2021 ndaj pasurive në zotërim të kërkuesit të parë. Procedimi pasuror u bazua në aktet dhe dokumentacionin e dorëzuar nga kërkuesi i parë, në cilësinë e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar sipas nenit 179/b, pika 3, të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Në funksion të hetimit pasuror, Prokuroria e Posaçme ka caktuar ekspert kontabël për llogaritjen e të ardhurave, shpenzimeve familjare dhe aftësisë paguese të kërkuesit të parë dhe ka konstatuar, ndër të tjera, se ai ka zotëruar pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament”, me sipërfaqe 60 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Kryemëdhenj, njësia administrative Golem, bashkia Kavajë (*pasuria objekt sekuestrimi*). Sipas prokurorisë, pasuria ishte regjistruar në emër të vëllait të tij Latif Dedja (*kërkuesi i dytë*), me qëllim fshehjen e saj.

4. Në vijim, në datën 16.04.2021 Prokuroria e Posaçme ka kërkuar në gjykatë vendosjen e masës parandaluese pasurore të sekuestrimit për apartamentin, me argumentin se plotësohen

kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin nr. 10192/2009, pasi ajo rrjedh nga veprimtaria kriminale e fshehjes së pasurisë, nuk justifikohet me burime të ligjshme dhe ka rrezik për tjetërsimin e saj. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 8, datë 20.04.2021, ka pranuar kërkesën e prokurorisë dhe ka vendosur masën e sekuestrimit, me arsyetimin se ekziston një rrezik real për transferimin ose tjetërsimin e pasurisë të persona të tretë, që do të pamundësonte konfiskimin e saj.

5. Mbi bazën e ankimit të të dy kërkuessve, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 132, datë 01.06.2021, ka vendosur miratimin e vendimit nr. 8, datë 20.04.2021 të GJKKO-së së Shkallës së Parë me të njëjtin arsyetim. Në këtë vendim ajo është shprehur se *“konkluzionet e gjykatës të arritura në këtë fazë, sipas parashikimit të nenit 21 e 22 të ligjit specifik, mund të verifikohen edhe gjatë seancës së konfiskimit. Me fjalë të tjera, ligjvënësi ka parashikuar nëse në procedurën e konfiskimit, në kontradiktoritet të provave të ofruara z. Bashkim Dedja, i cili ka barrën e provës, do të vërtetojë se pasurinë e ka vendosur në mënyrë të ligjshme, i jepet mundësia ligjore të pengojë marrjen e vendimit të konfiskimit, me pasojën e rënies së sekuestrimit”* (shih faqet 15 dhe 16 të vendimit të GJKKO-së së Apelit).

6. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-815, datë 21.10.2021, ka vendosur mospranimin e rekurseve të të dy kërkuessve, me arsyetimin se ato nuk përmbajnë ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

7. Në datën 21.02.2022 kërkuessit kanë paraqitur ankim në Gjykatë, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të të tria shkallëve, si dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në GJKKO-në e Shkallës së Parë ose në atë të apelit.

8. Me vendimin e datës 12.04.2022, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 04.05.2022, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

9. Prokuroria e Posaçme, krahas prapësimeve për kërkesën objekt gjykimi, ka informuar Gjykatën se kjo prokurori, me shkresën nr. 140 prot. (D.M), datë 22.04.2022, bazuar në ligjin nr. 10192/2009, ka dërguar në GJKKO-në e Shkallës së Parë kërkesën për konfiskimin e pasurisë objekt sekuestrimi në zotërim të kërkuessit të parë, duke bashkëlidhur aktin përkatës.

10. Gjykata në datën 22.09.2022 ka zhvilluar seancën e parë plenare dhe deri në datën 27.09.2022 ka biseduar për marrjen e vendimit, por pa arritur kuorumin e nevojshëm prej 5 anëtarësh. Ndërkohë, ka konstatuar se ekzistonte mundësia për përfshirjen e gjyqtarit Ilir Toska, i cili nuk kishte marrë pjesë në gjykim, pasi kishte filluar detyrën në datën 26.09.2022. Në këto rrethana, Gjykata, bazuar në nenin 73, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000 ka vendosur riçeljen e seancës në datën 13.10.2022 dhe shqyrtimin e çështjes nga e para, me pjesëmarrjen edhe të gjyqtarit të ri.

## II

### **Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese**

11. **Kërkuesit** kanë parashtruar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

11.1. *Mjetet juridike janë shteruar*, pasi vendimi i sekuestrimit të pasurisë konsiderohet përfundimtar, sepse cenon drejtpërdrejt dhe menjëherë të drejtat e pronës dhe të procesit të rregullt, të mbrojtura nga neni 42 i Kushtetutës, neni 6 i KEDNJ-së, si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj. Cenimi i të drejtave themelore ka sjellë rezultat të gabuar të hetimit dhe gjykimit penal, duke rrezikuar deri në pamundësi rivendosjen e këtyre të drejtave në procesin e mëpasshëm penal. Nëse konstatohen këto shkelje, nuk duhet lejuar vazhdimi i proceseve gjyqësore, sepse do të cenoheshin e drejta për proces të rregullt ligjor brenda afatit të arsyeshëm dhe parimi i sigurisë juridike.

11.2. Gjykatat kanë cenuar *të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

11.2.1. *Parimi i gjykatës së krijuar me ligj*, pasi ato kanë vepruar në kundërshtim me ligjin procedural dhe ligjin e posaçëm. Kërkuesve nuk iu janë njoftuar vendimi për caktimin e ekspertit dhe akti i ekspertimit kontabël, duke iu hequr mundësinë e ushtrimit të të drejtave të tyre.

11.2.2. *Parimi i sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*, pasi provat vendimtare në dhënien e vendimit gjyqësor janë akte absolutisht të pavlefshme dhe GJKKO-ja e Apelit nuk i shpalli të pavlefshme. Kjo shkelje nuk u riparua as nga Gjykata e Lartë, ndonëse ka në kompetencë kontrollin e gjykatave më të ulëta.

- 11.2.3. *Parimi i barazisë para ligjit*, pasi Gjykata e Lartë ka vepruar në kundërshtim me praktikën e saj të mëparshme në raste të ngjashme.
- 11.2.4. *E drejta e mbrojtjes*, pasi GJKKO-ja e Apelit dhe në vijim edhe Gjykata e Lartë nuk pranuan të shqyrtonin provat e paraqitura nga kërkuesit, ndonëse sipas ligjit mbi ta rëndonte barra e provës. Në këtë mënyrë, i gjithë procesi është bazuar vetëm në provat e prokurorisë, duke cenuar për pasojë edhe *të drejtën për t'u dëgjuar*, si dhe *parimet e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*.
- 11.2.5. *Parimi i paanësisë*, pasi GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë dhënë vlerë të paracaktuar kërkimeve dhe provave të prokurorisë.
- 11.2.6. *E drejta e pronës*, pasi ekzekutimi i menjëhershëm i sekuestrimit të pronës, të vendosur me një proces të parregullt gjyqësor, e ka kaluar atë në administrim të shtetit, duke i shkaktuar pronarit dëm gjer në shkatërrimin e saj.
- 11.2.7. *E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtin fakt*, pasi në këndvështrim të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), deklaratat dhe përfundimet në procesin disiplinor të rivlerësimit kalimtar lidhur me “fshehjen e apartamentit” përdoren edhe në procesin penal.

12. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

- 12.1. Kërkuesit *nuk i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive* për mbrojtjen e të drejtave të tyre, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi vendimi gjyqësor për sekuestrimin e pasurisë, sipas ligjit nr. 10192/2009, nuk ka natyrë përfundimtare për të drejtat kushtetuese të tyre, pasi procesi nuk ka përfunduar. Kufizimet e pronës janë vendosur për t'i shërbyer interesit publik për parandalimin dhe goditjen e krimeve të rënda përmes sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të personave të dyshuar ose të dënuar për kryerjen e këtyre krimeve.
- 12.2. Pretendimi i kërkuesve për cenimin e *parimit të gjykatës së caktuar me ligj* nuk qëndron, pasi kërkuesi i parë ka ushtruar detyrën e anëtarit dhe kryetarit të

Gjykatës Kushtetuese dhe për këtë shkak ai është subjekt i Prokurorisë së Posaçme, sipas parashikimeve të nenit 75/a, shkronja “ç”, të KPP-së.

- 12.3. Pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor është i pabazuar. Kërkuesit kanë të drejtë të paraqesin të gjitha provat për të mbrojtur të drejtën e pronësisë gjatë procesit të konfiskimit, i cili ka karakter përfundimtar, në ndryshim nga procesi i sekuestrimit që është urgjent dhe i përkohshëm. Gjatë gjyqimit në apel të ankimit nuk mund të merren prova të tjera përveç atyre që i kanë shërbyer gjyqtarit në shkallë të parë për marrjen e vendimit në dhomë këshillimi. Çdo provë të re pala mund ta paraqesë gjatë procesit hetimor përpara prokurorit ose duke paraqitur në gjykatë kërkesë për revokimin e sekuestrimit. Provat e reja nuk mund të merren *a priori* nga gjykata, pa iu nënshtruar verifikimit paraprak nga prokurori për vërtetësinë e tyre. Po kështu, pretendimi për mosnjohimin e vendimit të ekspertimit duhet rrëzuar, pasi kërkuesi i parë e ka marrë cilësinë e të hetuarit kur ekspertët kanë dorëzuar aktin e ekspertimit. Gjykatat e kanë arsyetuar shumë qartë vendimmarrjen e tyre.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesve

13. Çështja e legjitimitimit të subjekteve që mund t'i drejtohen Gjykatës është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Gjykata vëren se kërkuesit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2 të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor gjatë të cilit janë dhënë vendimet e kundërshtuara dhe, për rrjedhojë, kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen.

15. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individi duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeliemeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 75, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata thekson se rregulli për shterimin e mjeteve juridike efektive në dispozicion të individit zbatohet nën dritën e rrethanave të veçanta që paraqet çështja konkrete. Në thelb, ky rregull synon t’u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Për këtë arsye, mjetet juridike në dispozicion të kërkuesit nuk përfshijnë vetëm ankimin kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, por çdo ankim ose kundërshtim, duke u ofruar mundësi organeve publike dhe gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të luajnë rolin e tyre subsidiar për t’i garantuar individit mbrojtjen e të drejtave kushtetuese para se ai t’i drejtohet Gjykatës. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime te organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese.

17. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se pretendimi i kërkuesve, i paraqitur në parashtrimet shtesë të datës 06.06.2022, që lidhet me cenimin e së drejtës për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtin fakt, përveçse është parashtruar prej tyre për herë të parë në këtë akt dhe përtej afatit ligjor 4-mujor, është paraqitur drejtpërdrejt përpara Gjykatës, duke mos shteruar paraprakisht mjetet juridike efektive që ata kanë pasur në dispozicion, në kuptim të nenit 131,

pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim prej saj. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata vëren se kërkuesit i kanë parashtruar ato edhe më herët në ankimet e tyre drejtuar gjykatave më të larta të juridiksionit të zakonshëm.

18. Gjykata, bazuar në llojin e procedurës gjyqësore të sekuestrimit të pasurisë, për të konkluduar nëse kërkuesit kanë shteruar mjetet juridike efektive, vlerëson me rëndësi të përcaktoshme nëse ky proces gjyqësor ka natyrë përfundimtare, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

19. Kërkuesit pretendojnë se vendimi për sekuestrimin e pasurisë, për nga natyra dhe pasojat që sjell në të drejtat kushtetuese, është objekt shqyrtimi nga Gjykata, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Sipas kërkuesve, në kushtet kur çështja e tyre është gjykuar nga Gjykata e Lartë, vendimi është i pakthyeshem, i pandryshueshem dhe i pacenueshem, përveçse me mjete të jashtëzakonshme, sikurse instituti i rishikimit. Vendimi i sekuestrimit të pasurisë, sipas ligjit nr. 10192/2009, cenon drejtpërdrejt të drejtën e pronës të parashikuar dhe të mbrojtur nga neni 42 i Kushtetutës, neni 6 i KEDNJ-së, si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj. Procesi i sekuestrimit të pasurisë është një procedurë autonome, i bazuar në indicie, i pavarur nga procedimi penal ose nga rezultatet e tij dhe ekzekutohet menjëherë. Për nga natyra, vendimi i sekuestrimit të pasurisë ngjan dhe ndjek pothuajse të njëjtën “rrugë procedurale” sikurse vendimi për caktimin e masës së sigurimit personal në fushën penale, që cenon lirinë e personit dhe vendimi për sigurimin e padisë në fushën civile, që cenon të drejtën e pronës, të cilat ndonëse konsiderohen si jopërfundimtare, për nga rëndësia e të drejtave që prekin dhe pasojat e drejtpërdrejta dhe të menjëhershme që sjellin, janë konsoliduar tashmë si praktikë gjyqësore nga Gjykata dhe GJEDNJ-ja.

20. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme ka prapësuar se kërkuesit nuk i kanë ezauruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave të tyre, sipas parashikimeve të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi vendimi gjyqësor për sekuestrimin e pasurisë, sipas ligjit nr. 10192/2009 nuk ka natyrë përfundimtare për të drejtat kushtetuese. Kufizimet e pronës janë vendosur për t’i shërbyer interesit publik të parandalimit dhe goditjes së krimeve të rënda përmes sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të personave të dyshuar ose të dënuar për kryerjen e këtyre krimeve. Sekuestrimi i pasurisë ka si tipar urgjencën e ndërhyrjes dhe përkohshmërinë e zbatimit të masës, pra heqjen e së drejtës së administrimit të pronës për



një periudhë të caktuar kohore, ndërsa konfiskimi ka si tipar verifikimin më të thelluar të kërkesës nga ana e gjykatës dhe kalimin përfundimtar të pasurisë në favor të shtetit. Gjatë kësaj procedure të fundit, kërkuessit kanë të drejtë të administrojnë të gjitha dokumentet që i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor për të mbrojtur të drejtën e tyre të pronësisë.

21. Mbështetur në rrethanat e faktit të çështjes konkrete, Gjykata nuk vë në dyshim karakterin e ndërmjetëm të vendimit të sekuestrimit të pasurisë, në kuptim të rolit që ky vendim luan në procedurën dhe vendimmarrjen përfundimtare për konfiskimin e pasurisë. Megjithatë, në raste përjashtimore, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore të ndërmjetme, nëse plotësohen njëherazi tre kushte: (i) kur shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm; (ii) vendimi i ndërmjetëm të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe gjykatat më të larta të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; dhe (iii) vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjithashtu, Gjykata është shprehur edhe në lidhje me vendimet gjyqësore për vendosjen e masës së sekuestrimit konservativ ndaj një pasurie të paluajtshme, në kuadër të procedimit penal ende të papërfunduar. Ajo ka vlerësuar se ky lloj vendimi gjyqësor nuk është përfundimtar, pasi masa e sekuestros konservative është një masë sigurimi pasuror, që caktohet me vendim të ndërmjetëm të gjykatës dhe efektet e saj pushojnë kur vendimi i pafajësisë ose i pushimit të çështjes penale ka marrë formë të prerë. Sekuestroja konservative, si masë sigurimi pasuror, është në funksion të procesit penal që zhvillohet ndaj të pandehurit dhe vendosja e saj mund të ankimohet bashkë me vendimin përfundimtar të këtij procesi. Sipas Gjykatës, interesi i kërkuessit buron nga e drejta e pretenduar e pronës, që në vështrim të mjeteve të lejueshme dhe mundësive procedurale që parashikon legjislacioni në fuqi, ai (kërkuessi) ka ende mjete për vendosjen në vend të kësaj të drejte, pasi përveç ankimit bashkë me vendimin përfundimtar, sipas nenit 407 të KPP-së, mund t'u drejtohet gjykatave të juridiksionit të zakonshëm referuar dispozitave të Kodit Civil (*shih vendimin nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Gjykata vëren se vendimi i ndërmjetëm për vendosjen e masës së sekuestrimit është bërë objekt i ankimit në GJKKO-në e Apelit dhe i

rekursit në Gjykatën e Lartë, të cilat e kanë lënë në fuqi. Për shkak të kësaj mase, kërkuesve u është kufizuar e drejta kushtetuese e pronës, pasi ata nuk mund ta disponojnë lirisht atë. Megjithatë, vendimi i sekuestrimit është i përkohshëm, nuk cenon thelbin e së drejtës së pronës dhe nuk ka natyrë përfundimtare, pasi në çdo kohë kërkuesit mund t'i drejtohen gjykatës së juridiksionit të zakonshëm për revokimin e masës (*shih nenet 12/b dhe 13 të ligjit nr. 10192/2009*). Për më tepër, vendimmarrja për sekuestrimin nuk ka masën e duhur të autonomisë nga procesi i konfiskimit të pasurisë, vendimi i të cilit ka aftësinë të ndryshojë dhe të riparojë në masën e duhur efektet që sekuestrimi ka sjellë. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se në datën 22.04.2022 Prokuroria e Posaçme ka përcjellë në GJKKO-në e Shkallës së Parë kërkesën për konfiskimin e pasurisë objekt sekuestrimi, vlerëson se kërkuesit kanë ende mjete në dispozicion që parimet dhe të drejtat e pretenduara si të cenuara gjatë fazës së sekuestrimit t'i shërojnë nëpërmjet procedurës së konfiskimit, e cila ka natyrë përfundimtare.

24. Në përfundim, Gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar për sekuestrimin e pasurisë nuk konsiderohet përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, për rrjedhojë kërkuesit nuk legjitimohen për paraqitjen e këtij ankimi kushtetues individual.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

### **V E N D O S I:**

#### **1. Rrëzimin e kërkesës.**

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Marrë më 13.10.2022**

**Shpallur më 11.11.2022**

## MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e ankimit kushtetues individual të paraqitur nga kërkuesit Bashkim Dedja dhe Latif Dedja (*kërkuesit*), me objekt shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të apelit dhe asaj të shkallës së parë (*GJKKO-ja e Apelit dhe GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), si të papajtueshme me Kushtetutën, jemi kundër vlerësimit të shumicës së vendimi për sekuestrimin e pasurisë nuk konsiderohet përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Me të drejtë shumica parashton se në rastin konkret *“nuk vë në dyshim karakterin e ndërmjetëm të vendimit të sekuestrimit të pasurisë, në kuptim të rolit që ky vendim luan në procedurën dhe vendimmarrjen përfundimtare për konfiskimin e pasurisë. Megjithatë, në raste përjashtimore, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore të ndërmjetme, nëse plotësohen njëherazi tre kushte: (i) kur shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm; (ii) vendimi i ndërmjetëm të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe gjykatat më të larta të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; dhe (iii) vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese)”* (shih paragrafin 21 të vendimit).

3. Në vijim, shumica analizon rrethanat e faktit të çështjes konkrete dhe vlerëson me të drejtë se dy kushtet e para plotësohen. Ajo që na ndan me shumicën lidhet me analizën e kushtit të tretë *“nëse vendimi i sekuestrimit të pasurisë ka një masë autonomie nga procesi i themelit”*, kusht për të cilin shumica ka vlerësuar se nuk plotësohet, duke arsyetuar shprehimisht se *“vendimi i sekuestrimit është i përkohshëm, nuk cenon thelbin e së drejtës së pronës dhe nuk ka*

*natyrë përfundimtare, pasi në çdo kohë kërkuesit mund t'i drejtohen gjykatës së juridiksionit të zakonshëm për revokimin e masës (shih nenet 12/b dhe 13 të ligjit nr. 10192/2009). Për më tepër, vendimmarrja për sekuestrimin nuk ka masën e duhur të autonomisë nga procesi i konfiskimit të pasurisë, vendimi i të cilit ka aftësinë të ndryshojë dhe të riparojë në masën e duhur efektet që sekuestrimi ka sjellë. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se në datën 22.04.2022 Prokuroria e Posaçme ka përcjellë në GJKKO-në e Shkallës së Parë kërkesën për konfiskimin e pasurisë objekt sekuestrimi, vlerëson se kërkuesit kanë ende mjete në dispozicion që parimet dhe të drejtat e pretenduara si të cenuara gjatë fazës së sekuestrimit t'i shërojnë nëpërmjet procedurës së konfiskimit, e cila ka natyrë përfundimtare” (shih paragrafin 23 të vendimit).*

4. Në themel të këtij arsytimi janë parashtruar dy argumente se përse masa e sekuestrimit nuk ka masën e duhur të autonomisë nga masa përfundimtare e konfiskimit. Konkretisht, bëhet fjalë për: (i) përkohshmërinë e masës së sekuestrimit; (ii) dhe aftësinë e procesit të konfiskimit, që ka natyrë përfundimtare, të shërojë parimet dhe të drejtat që cenohen gjatë fazës së sekuestrimit.

5. Në vlerësimin tonë, përkohshmëria e masës së sekuestrimit nuk përbën argument kushtetues, pasi garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nuk lidhet me kohëzgjatjen e ushtrimit të tyre ose të veprimit, që ndërhyt dhe i cenon ato. Kjo do të thotë se Kushtetuta nuk përjashton mbrojtjen e së drejtës kushtetuese, nëse shkelja e saj është e përkohshme. Kushtetuta garanton liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, duke parashikuar parimin themelor se ato janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik (neni 15, pika 1) dhe se organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet t'i respektojnë ato dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre (neni 15, pika 2). Thënë ndryshe, çdo individ lind dhe gëzon të njëjtat të drejta themelore, të cilat janë të patjetërsueshme, sepse nuk mund t'i hiqen individit; asnjëra prej tyre nuk mund të gëzohet pa të tjerat, sepse janë të pandashme; ato duhet të garantohen nga mekanizmat mbrojtës të pushtetit publik, sepse janë të padhunueshme; mbrojtja e tyre është detyrë e shtetit të së drejtës. Për shkak të këtyre karakteristikave, Kushtetuta parashikon përgjegjësitë konkrete të pushtetit publik për realizimin e tyre, si dhe mekanizmat mbrojtës për shkeljet eventuale, ku përfshihet edhe ankimi kushtetues individual.

6. Duke vijuar këtë linjë arsyetimi, duhet theksuar se vendimi i sekuestrimit ndërhyrës përkohësisht në të drejtën kushtetuese të pronës private. Kjo ndërhyrje, si rregull, zgjat për aq kohë sa zhvillohet procedimi pasuror deri në dhënien e vendimit përfundimtar për konfiskimin e pasurisë. Në çështjen konkrete, kërkesa e Prokurorisë së Posaçme për sekuestrimin e pasurisë është pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë në datën 20.04.2021 dhe në kohën e shqyrtimit të çështjes në Gjykatë, më 13.10.2022, procedimi pasuror gjendej në fazën e gjykimit të kërkesës për konfiskim në gjykatën e shkallës së parë. Këto të dhëna tregojnë se ndërhyrja në të drejtën e pronës ka vazhduar për rreth 1 vit e 6 muaj dhe është e pritshme të zgjasë, duke mbajtur në konsideratë edhe kohën e duhur për përfundimin e procesit gjyqësor të konfiskimit, përfshirë shqyrtimin eventual të ankimeve në gjykatat më të larta. Në këtë këndvështrim, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, bazuar në nenet 15 dhe 42 të Kushtetutës, kanë detyrimin kushtetues të respektojnë dhe të kontribuojnë për realizimin e të drejtave kushtetuese individuale, që do të thotë se vendimi për një masë të tillë, që kufizon të drejtën e pronës, duhet të jepet në përputhje me standardet e procesit të rregullt ligjor dhe gjykimi nuk duhet të jetë arbitrar.

7. Për sa më lart, argumenti për natyrën e përkohshme të masës së sekuestrimit, i përdorur për ta përjashtuar vendimin e sekuestrimit nga kontrolli kushtetues, rrezikon qartazi të mohojë mekanizmin kushtetues për mbrojtjen e të drejtave themelore. Për më tepër, përkohshmëria duket se nuk është vlerësuar edhe nga vetë Gjykata si element përcaktues në këto raste, pasi ajo ka pranuar juridiksionin e saj për kontrollin e vendimeve gjyqësore të masave të sigurimit personal “arrest në burg”, të cilat, gjithashtu, janë vendime jopërfundimtare, të përkohshme dhe që mund të revokohen ose ndryshohen përgjatë procedimit penal gjer në dhënien e vendimit përfundimtar për fajësinë e të pandehurit (*shih vendimin nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Nën këtë analizë, elementi që duhej analizuar dhe është përcaktues për zgjidhjen e kësaj çështjeje lidhet me masën e autonomisë që vendimi i ndërmjetëm i sekuestrimit ka ndaj vendimit përfundimtar të konfiskimit.

9. Në parim duhet theksuar se Gjykata është treguar e kujdesshme kur ka zhvilluar jurisprudencën për kushtet përjashtimore të përfshirjes në juridiksionin e saj të vendimeve të ndërmjetme dhe për kushtin që u debatua në këtë gjykim është shprehur saktësisht se duhet që “vendimi i ndërmjetëm të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit” (*shih paragrafin 33 të vendimit nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Pra, bëhet fjalë për “një masë

*autonomie*” dhe jo autonomi të plotë, gjë që përputhet me natyrën e vendimit të ndërmjetëm, i cili në çdo rast jepet nga gjykata brenda dhe në funksion të procesit që zgjidh mosmarrëveshjen gjyqësore me vendim përfundimtar. Në këtë mënyrë, e domosdoshme për plotësimin e kushtit në fjalë mbetet aftësia që vendimi përfundimtar ka për të riparuar efektet e vendimit të ndërmjetëm, në kuptimin që nëse vendimi përfundimtar kontrollon dhe rivendos të drejtën e shkelur nga vendimi i ndërmjetëm, atëherë ky i fundit nuk ka masën e duhur të autonomisë për qëllime të juridiksionit kushtetues.

10. Duke u kthyer te vendimi i sekuestrimit, konstatohet se ai ka lidhje organike funksionale me vendimin përfundimtar të konfiskimit, meqë masa e sekuestrimit vendoset për të garantuar suksesin e ekzekutimit të konfiskimit. Rrjedhimisht, për të përcaktuar masën e autonomisë, pra se sa i aftë është vendimi i konfiskimit të riparojë efektet e shkeljeve eventuale të shkaktuara nga vendimi i sekuestrimit, merr rëndësi të analizohen objektet e gjykimeve të sekuestrimit dhe të konfiskimit.

11. Duke vijuar analizën në këtë drejtim, vihet re se objekti i gjykimit të sekuestrimit është mbledhja e fakteve dhe zbatimi i neneve 11-14 të ligjit nr. 10192/2009 për të nxjerrë përfundimin nëse ka dyshime të arsyeshme që pasuria, për të cilën ka filluar procedimi pasuror i konfiskimit, mund të tjetërsohet, shpërndahet, transferohet, shpërdorohet, fshihet ose zhvlerësohet. Ndërsa objekti i gjykimit të konfiskimit është mbledhja e fakteve dhe zbatimi i neneve 21-25 të ligjit nr. 10192/2009 për të nxjerrë përfundimin nëse burimi i pasurisë (së sekuestruar ose jo) është rrjedhojë e veprimtarisë së krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera. Thënë këtë, është e qartë se vendimi përfundimtar i konfiskimit disponon në mënyrë përfundimtare për pasurinë, e cila mund të jetë sekuestruar ose jo, por në gjykimin e konfiskimit nuk kontrollon më rregullsisht e procesit të zhvilluar për sekuestrimin dhe drejtësia e masës së sekuestrimit, një gjë e tillë është tërësisht e përjashtuar nga objekti i gjykimit të konfiskimit. E njëjta gjë ndodh edhe me ankimin eventual që individit mund të bëjë në gjykatat më të larta kundër vendimit të konfiskimit. Në një situatë të tillë, nëse individit në ankimin kundër masës së konfiskimit ngre shkaqe për parregullsitë e procesit të sekuestrimit, ato janë të papranueshme, pasi kanë qenë objekt verifikimi i procesit të sekuestrimit, për të cilin ligjvënësi ka parashikuar ankim të veçantë gjer në Gjykatën e Lartë.

12. Edhe alternativa që individit mund t'i drejtohet sërish gjykatës me kërkesa për revokim të sekuestrimit, nuk do të thotë që gjykata me vendimin e revokimit riparon efektet e një

procesi eventual të parregullt sekuestrimi, por verifikon nëse kanë rënë kushtet e sekuestrimit në kohën që paraqitet kërkesa për revokim. Me fjalë të tjera, vendimi i revokimit të sekuestrimit ose vendimi përfundimtar i konfiskimit në alternativën më të favorshme (*in meius*) për individin ndalon shkeljen e mëtejshme të së drejtës kushtetuese të pronës së tij, por nuk është i aftë të riparojë shkeljet eventuale në drejtim të kufizimit të kësaj të drejte që kanë ndodhur në procesin gjyqësor të sekuestrimit.

13. Si përfundim, në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, vlerësojmë se vendimi i sekuestrimit ka masën e duhur të autonomisë nga vendimi përfundimtar i konfiskimit dhe se vendimet gjyqësore që kanë disponuar për masën e sekuestrimit për pasuritë e individit, bazuar në ligjin nr. 10192/2009, duhet t'i nënshtrohen kontrollit kushtetues, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës.

14. Për të gjitha arsyet e mësipërme, ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë se ankimi kushtetues kishte në objektin e tij një vendim përfundimtar dhe se Gjykata duhet të shqyrtonte dhe të vendoste për themelin e pretendimeve të kërkuësve.

**Anëtarë: Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari**